



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr. 657/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Gyltene Sylejmani kryesuese, Ymer Hoxha dhe Afijete Sada-Gillogjani anëtarë, me pjesëmarrjen e Zyrtares Ligjore Arjeta Sylja, duke vendosur përkitazi me ankesën e Branko Simić, kandidat për anëtar të Kuvendit Komunal të Parteshit, nga radhët e subjektit politik Lista Serbe, me seli në Mitrovicën e Veriut, dega në Partesh, paraqitur kundër vendimit të KQZ-së me numër 2232-2017 të datës 08.11.2017, për shpalljen e rezultateve përfundimtar të Zgjedhjeve Lokale për Kuvendet Komunale, të mbajtura më datë 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur më datë 10.11.2017, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e Branko Simić, kandidat për anëtar të Kuvendit Komunal të Parteshit, nga radhët e subjektit politik Lista Serbe, me seli në Mitrovicën e Veriut, dega në Partesh, me shenjën ZL.Anr.657/2017 të datës 09.11.2017, paraqitur kundër vendimit të KQZ-së me numër 2232-2017 të datës 08.11.2017 për shpalljen e rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për Anëtarët e Kuvendit Komunale të mbajtura më datë 22.10.2017.

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar një ankesë me datë 09.11.2017, nga Branko Simić, kandidat për anëtar të Kuvendit Komunal të Parteshit, nga radhët e subjektit politik Lista Serbe, me seli në Mitrovicën e Veriut, dega në Partesh, me të cilën ka kërkuar që të rinumërohen votat në fshatin Ranillug në Vendvotimet 3501D/01R dhe 3501D/02D, sepse konsideron se i janë vjedhur votat.

PZAP-i, pas shqyrtimit të besueshmërisë së ankesave dhe vlerësimit të pretendimeve ankimore, që gjenden në shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 117 paragrafi 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Ankesa është e pabazuar

PZAP-i, konstatoi se pretendimet ankimore janë të pabazuara ngase parashtruesi i ankesës nuk i ka bashkangjitur asnjë provë.

Parashtrimet në ankesë nuk paraqesin bazë ligjore për parregullsi gjatë procesit të numërimit të votave në qendrën e votimit të sipërcituara dhe për rrjedhojë as referencë ligjore për marrjen e vendimit në favor për ankuesin .

Paneli vlerësoi se pretendimet në ankesë nuk janë te bazuara dhe nuk i plotësojnë standardet ligjore të përcaktuara me dispozitat e nenit 5.7 pika c) të Rregullës së PZAP-it 02/2015 si dhe të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së.

Paneli, në mungesë të provave dhe dëshmive konkrete dhe bindëse lidhur me pretendimet e paraqitura në ankesë, konstaton se ankesa në fjalë është e pa argumentuar me fakte dhe si e tillë është e pabazuar .

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë në nenin 117 dhe 118 par. 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

ZL.Anr.657/2017 më datën 10.11.2017.

Kryesuese e Panelit
Gylishe Sylajman



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.